

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË
“ARTALB FILM Productions” SH.P.K.**

Mbeshtetur ne Ligjin nr. 8417, date 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikes se Shqiperise”, të ndryshuar, Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, te ndryshuar, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” si dhe Ligjin nr. 129/2014, “Per disa shtesa dhe ndryshime ne nr. 9901, date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” te ndryshuar” dhe dispozitave te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise ne fuqi, me vullnet te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akti themelimi dhe statuti, une, Gentian KOÇI, i biri i Rexhep Koçit, lindur me 19 mars 1979, ne Tirane, banues ne Tirane, ne adresen Rr. “Mustafa Mehidri”, Njesia 1, Nd. 64, AL-1005, Tiranë, posedues i kartes se identitetit nr. 033418562 dhe nr. personal H90319061J, shtetas shqiptar, vendosa te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar, datë 4 shtator 2018, në Tiranë, emertuar si me poshte:

Neni 1

Emertimi i shoqerise eshte “ARTALB FILM Productions” sh.p.k.

Neni 2

Ky Statut hyn ne fuqi pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “**ARTALB FILM Productions**” **sh.p.k.**, themeluar nga z. Gentian KOÇI, ortak i vetem, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Neni 4

Shoqeria ka seline ne Tirane, ne adresen Rr. “Mustafa Mehidri”, Njesia 1, Nd. 64, AL-1005, Tiranë.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e kinematografise:
 - Prodhim dhe distribucion te veprave audiovizuale si filma fikSION te metrazhit te gjate, te shkurter, filmit dokumentar te metrazhit te



shkurter, te mesem dhe te gjate, filma te animuar, si dhe prodhime te tjera audiovizuale, etj.;

2. E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të mbështetet në licencat e leshuara për këto qëllime nga organet përkatëse shtetërore.

Neni 6

Administratori i shoqërisë është z. Gentian KOÇI.
Administratori ushtron detyrën me afat 5 vjet.
Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut të vetëm.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Neni 7

Kohezgjatja e veprimtariës së Shoqërisë është e pakufizuar.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 8

- Kapitali fillestar i shoqërisë është 5.000 (pesëmijë) Leke, prona e ortakut të vetëm.
- Ortaku i vetëm **Z. Gentian Koçi** është zotuesi i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakesohet (për jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).
- Ortaku i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundërt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij me kapitalin themeltor të shoqërisë.

Neni 9

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet sipas dispozitave ligjore, apo vendimit të ortakut të vetëm.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 10

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmbanë në Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe e regjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit të Shoqërive Tregtare (QKB).



Neni 11

Ortaku i vetem i shoqerise, me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tij nuk mund ta terheqe. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoqerise per fitimin e realizuar.

Neni 12

Vendimi i ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise, qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Vendimi i ortakut te vetem brenda nje afati prej tre muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore te hartuara nga administratori.

Neni 13

Ndryshimet ne Statut

Ndryshimet ne statut vendosen nga ortaku i vetem. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

ADMINISTRIMI

Neni 14

Shoqeria administrohet nga administratori, i cili caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Ortaku i vetem. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe 5 vjeçare me te drejte riperseritjeje. Ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, vendoset shkarkimi i administratorit duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem edhe nga specialistet perkates.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise ua jep shprehimisht ortakeve.

Administrator i shoqerise eshte: **Z. Gentian KOÇI**, shtetas shqiptar, i biri i Rexhep Koçit, lindur me 19 mars 1979, ne Tirane, dhe banues ne Tirane, ne adresen Rr. "Mustafa Mehidri", Njesia 1, Nd. 64, AL-1005, Tiranë,



mbajtes e kartës së identitetit me nr. 033418562 dhe nr. personal H90319061J, madhor, e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Neni 15

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet e parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Pergjithshme.

Neni 16

Administratori ka te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme per furnizime publike private, te ndermarre veprime gjyqesore per dhe ne emer te shoqerise, etj. Administratori mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh. Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per çdo veprim gjyqesor apo jashtegjyqesor.

Administratori eshte i detyruar te mbaje konform ligjit te gjitha regjistrat e domosdoshëm per aktivitetin e shoqerise. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te mbaje inventare te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per çdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me parjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Administratori eshte pergjegjes per administrimin e shoqerise dhe informon ortaket per ecurine e veprimtarise tregtare te shoqerise. Gjate veprimtarise se tij ai vepron duke marre parasysh interesat e shoqerise, duke zbatuar parimet e detyrimit te besnikerise.

MARREDHENIET E PUNES

Neni 17

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga



veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 18

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i kesaj shoqerie.

EKSPERTI KONTABEL

Neni 19

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje ekspert kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te veçanta ligjore.

BILANCI

Neni 20

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar.

Neni 21

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve per mundesine e prishjes se shoqerise.

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 22

Ne rast se shoqeria priset per çdo lloj arsye Asambleja e Pergjithshme percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per ç'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Neni 23

MOSMARREVESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin, apo



interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindre ndermjet shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente per zgjidhjen e tyre Gjykata Administrative e rrethit gjyqesor Tirane.

Neni 24

Shoqeria do te kete vulen dhe logon e saj.

Ky statut hartohet me vullnetin e ortakut dhe nenshkruhet prej tij sipas ligjit.

ORTAKU I VETEM

Gentian KOÇI

Gentian Koçi

